



Pranuar / Dorezuar Primitjen / Prodato Received / Delivery	03.08.2023	3	vite god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHUK	5502/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.879/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.879/2023 të datës 23.06.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted] në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 03.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.879/2023 e datës 23.06.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II.Obligohet Kryetari i Komunës së Pejës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit, ankuesit [redacted] i bëjë kompensimin për vdekjen e anëtarit të ngushtë të familjes-djalit, në një shumë monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

III.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar i Z.K.Gj.C. në Pejë", në Drejtorin për Administratë në Z.K.Gj.C në Komunën e Pejës, me datë 23.06.2023 dhe me numër protokollit 4889/2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 23.05.2023 të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës, me që rastë i ishte refuzuar kërkesa për kompensim me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë familjes-

djalit me arsyetimin se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ky lloj kompensimi nuk parashihet.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 29.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Pejës, ndërsa, kjo e fundit me datë 06.07.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat ndërlidhur me këtë çështje juridiko-administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e trajtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova:Ankesën me numër të protokollit 4889/2023 të datës 23.06.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërim Civil të Kosovës; Vendimin me nr.01-400/01-0046233/23 të datës 23.05.2023 nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës; Certifikata me numër V 10556150 e datës 19.12.2022 dhe Certifikata me numër V 10591274 e datës 08.05.2023 lidhur me vdekjen e anëtarit të familjes-djalit; Akt emërimit i ankuesit të datës 04.01.2012 me Nr.01-112-59.; kopja e letërnjoftimit e ankuesit; Formulari për Kërkesë apo ankesë i datës 23.5.2023; Kërkesën me numër 01-400/01-46129 të datës 22.05.2023; Deklarata për bashkësinë familjare me nr.F 11554793 e datës 09.06.2023; Certifikatë e martesës me nr.M 11395708 e datës 28.04.2022; Certifikatë e vdekjes e F.Sh. me nr.V 10556150.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi është i punësuar në Drejtorin për Administratë në Komunën e Pejës, pozitën e punës "Zyrtar i Z.K.Gj.C. "sipas Aktit të Emërimit të datës 04.01.2012 me Nr.01-112-59.

Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi më datë 22.05.2023 kishte parashtruar kërkesë te organi i punësimit për kompensimin e një page mesatare me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, gjegjësisht djalit të tij, ndërsa organi i punësimit përkatësisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës në vendimin e datës 23.05.2023 lidhur me kërkesën e datës 22.05.2023, ka refuzuar kërkesën e ankuesit me pretendimin se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ky lloj kompensimi nuk parashihet të bëhet dhe për këtë arsye kërkesa është refuzuar.

Ankuesi pas vendimit të datës 23.05.2023, me që rast i ishte refuzuar kërkesa e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi i datës 23.05.2023 i organit të punësimit është në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil nga se ky lloj i kompensimit parashihej sipas këtij ligji që ishte në fuqi në kohën e vdekjes së anëtarit të familjes së ngushtë-djalit.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-212 të Punës përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 dhe 2 të ku përcaktohet se: "1.Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës", "2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës", si dhe nenin 87 ku përcaktohet se: "Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej

tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës” konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, ngase sipas Certifikatës së Vdekjes V 10591274 të datës 08.05.2023, djali i ankuesit tani i ndjeri me inicialet F. Sh ka ndërruar jetë më datë 21.11.2022, moment nga i cili ka filluar të rrjedhë afti i parashkrimit të kërkesës së ankuesit për kompensim material dhe së deri në parashtrimin e kërkesës së ankuesit me datë 22.05.2023 nuk kanë kaluar tri vite, që është afat i parashkrimit referuar nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Kolegji në lidhje me këtë çështje ka analizuar edhe dispozitat ligjore të aplikueshme në kohën e vdekjes së djalit të ankuesit, përkatësisht Kolegji i u referuar dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ku me nenin 22 paragrafi 2 përcaktohej se: “2. Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; ..2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësi civil”; si dhe dispozitave të nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, ku parashihej se: “...2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil”, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes-djalit, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Kolegji i këshillit në lidhje me çështjen se si definohet përbërja e familjes së ngushtë, Kolegji ju referua Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht nenit 271 ku përcaktohet se: “Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji”. Lidhur me këtë fakt, Kolegji sjell në vëmendje Aktgjykimin A.A.nr.14/2017, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me të cilin është konfirmuar përkufizimi i familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes.

Nisur nga përcaktimi ligjor si me sipër, si dhe bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Certifikatat e vdekjes me numër V 10556150 e datës 19.12.2022 dhe Certifikata me numër V 10591274 e datës 08.05.2023, konstatohet se F.Sh gjegjësisht djali i ankuesit ka ndërruar jetë me datë 21.11.2022, kurse nga Certifikatat e bashkangjitura në shkresat e lëndës (certifikata e martesës e datës 28.04.2022 dhe e bashkësisë familjare e datës 09.06.2023), është vërtetuar se ankuesi ka jetuar me djalin e tij deri në momentin e vdekjes së të ndjerit, kështu që, duke iu referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbimin Civil, me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes- djalit është i bazuar, ndërsa detyrohet organi i punësimit në këtë rast kryetari i komunës së Pejës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.

Bazuar në at që u tha si më lartë e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi në ditën e anëshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.879/2023, datë 03/08/2023

Vjollca SINANI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Personelit në komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.